

BIBLIOTEKA

8JH-1  
T 81

# TOKA SHQIPTARE

POEZI

891. P 83 - 1

T 81

3

# TOKA SHQIPTARE

(Vëllim poetik i rrëthit letrar të Durrësit)

~~50974~~

LIBRARI E SHKËTËS  
GJURAJEVI

14571

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 Kopje    Format 70x100/32    Stash: 2204-65

---

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1969

## LEXUESIT

Në këtë vëllim po botojmë krijimet më të mira të poetëve të rinj të rrethit letrar të Durrësit. Inisiativa e këtij rrethi letrar që duhet përshëndetur do të ishte mirë të ndiqej edhe nga rrethet letrare të tjerë duke zgjedhur e duke dhënë për botim shkrimet më të realizuara të anëtarëve të tyre. Në këtë mënyrë do të merrte edhe më tepër hov krijimtaria e letrarëve të rinj e cila i shton gjak të ri poezisë sonë.

## TOKA SHQIPTARE

U kalbën mbi këtë tokë  
flamurët dhe uniformat,  
kockat dhe lavdia e armiqve.  
Si malet në këmbë qëndron Shqiptari  
me kazmën dhe pushkën pranë  
me idealet e Partisë  
ngritur flamur në zemër.

## KËNGËT

... Dhe këngët lindin  
Kur lindin trimat,  
Edhe nuk epen  
Edhe nuk vdesin,  
Shkëndijë e ndezur  
Mes zemrash mbesin.

## NË ATË SHTËPI!

Përreth asaj shtëpie nxinte nata katran,  
Ashtu nxinte ajo në tërë Atdhenë,  
Ndër zemra,  
Ndër këngë.

Qe natë,  
Por brenda zbardhëllonte ajo shtëpi  
Edhe pse vetëm një kandil  
Ndriste mbi tavolinë.  
Ndrisnin aty  
Drita e gjithë horizonteve të ardashme,  
Fuqia jetëdhënëse e këngëve tona,  
Çiltërsia e buzëqeshjeve tona.  
Ishin aty dhe amanetet e shokëve  
Që do të binin betejave.  
Mbi të gjitha, digjej aty në flakë të pambaruar  
Besimi ynë.

Qe natë,  
Por ajo nxinte për të fundit herë.  
Ja, ai do të firmoste themelimin  
E anembanë do të derdhej si shkumë katarakesh  
E gjithë drita që zbardhëllonte në atë shtëpi.  
Që atë çast Shqipëria s'do njihte më natë.



## UDHËT

Dhe udhët flasin  
Dhe udhët qeshin  
Dhe udhët gjëmojnë.  
Po udhët janë si njerëzit.

I keni parë udhët festave  
Kur veshin flamujt ngjyrëkuq,  
Kur ballit shpalosin banderola,  
Kur dehen nga aroma e këngëve,  
brohoritë  
E atëhere qeshin, qeshin, qeshin!

I keni parë udhët,  
Kur supeve mbartin maqina vigane  
Ngarkuar me fabrika,

Linja tensioni?

Mbartin vite të tërë pesëvjeçarë  
E atëhere buçasin, gjëmojnë, gumëzhijnë;  
I derdhur në hekur kalon revolucioni.

Udhët dinë të flasin  
Për ndarje,  
Takime.

Dhe të tregojnë për vite të egër  
Kur trupin ua shponin gozhdët e çizmeve,  
kur fshihnin ilegalët  
që ndanin traktet,  
Kur përmbi to kaloi komunisti  
Që e çonin për pushkatim.  
Kaloi pors pranverë buzagaz  
se e dinte që të tjerët  
do ndiqnin rrugën e tij  
duke u ngritur si tallaz.

Dhe udhët flasin dhe udhët qeshin  
dhe udhët gjëmojnë.

## NË KANTIER

Në kantierin e madh i nxorën maunet  
Dhe varkat e vjetra që u kalbën nga dallgët,  
Që u kripën nga bryma dhe u përplasën  
nga shkulmet

Në shkëmbinj dhe shpella,  
Ku këputnin spirancat.  
Rrinë ato të drunjtat  
Në rërën e trishtë,  
Me bashet e pjerrta si sqepe zgalemesh,  
Që pa krahë shohin detin dhe horizontin e lirë  
Me dëshirën e madhe  
Të njomen mes erërash;  
Prapë të shtegtojnë mbi rrymat e kaltra  
Si dikur bashkë me etrit tanë peshkatarë,  
Me detarët e thinjur  
Në netët e acarta.  
Koha u iku, por dhe në ditët tona,

Kur dielli i lirisë vezulloi në stuhi  
Shërbyen të geta  
Dhe do të shërbenin akoma  
Sikur t'u kish mbetur  
Sado pak fuqi.  
Por trishtimi i tyre i sinqertë  
Dhe i mirë  
Si legjendë shpërndahej në kantierin e madh  
Se mbi ta plot tinguj dhe avuj në hapësirë  
Tani vaporët tanë zbardhin  
Si mirazh.

## BABAJT TIM SHOFER

Ç'u bë, baba, ajo maqina e vjetër,  
«Graniti» që prishej aq shpesh?  
Në vend të saj more një tjetër,  
Një «Skodë» që ecën si rrebesh.

Tani nuk nxehesh si më parë,  
Nuk shan nëpër dhëmbë si dikur,  
Pranë timonit një kënge ja ke marrë  
Tek shpje në fabrikë zhavor e gurë.

Me të sa gjëra, baba, ti mbarte  
Në veprat që ngritëm ne vetë  
E ku nuk shkele në rrugë me gurë e baltë.  
Gjithmon' në udhëtim si retë.

Ti sot ja ke shkelur «Skodës» së re  
Pedalin gjer në dërrasë  
Vullnetarë po shpje në rrugën e re  
Po shpje një maqinë plot gaz.

Këndo dhe ti një këngë bashkë me ta  
Merrja «po shkojmë në aksion».  
Ku ka mbi këngët rinore, ku ka?  
Atdheu gjithnjë i këndon.

## ESKAVATORISTI

*(Vëllaut tim eskavatorist)*

Mbi eskavatorin buzë kanalit  
Fluturuan lejlekët  
Ngadalë me vozitje të gjera  
Të lodhur nga shtegtimi.  
Si ujvare u derdh dheu nga kova  
e eskavatorit.

Te xhamat e kabinës  
U rrotullua me xixëllim të purpurt  
Dielli buzë perëndimit,  
U rrotullua fusha  
Dhe deti pranë  
Dhe qielli me lejlekët vozitës.  
Në mes të projekteve  
Që përthyeshin mbi xham  
U duk eskavatoristi  
Në guvën e kabinës.  
Njërën dorë shtërnguar te leva e komandimit

Me tjetrën duke fshirë ballin e djersitur.  
Ai qëndroi ashtu një moment  
Si i gdhendur në një monument.



## VARGJE PËR CURRILAT

Në vargje të përshëndes o det, që më shqetëson.  
Ju, brigje ku peshkoja çdo agim me grep,  
Ju, kodra argjilore të gjelbëruara  
Me makje,  
Ju, ujëra ku vozita me rrema edhe vel.  
Pranë sopeve në ujë gërmadhat e kështjellës  
(Ky gji ka qenë qytezë dhe mali Skënderbeut)  
Të moçme zhurmojnë  
Në thellësi të legjendës  
Plot fosile lavdish dhe alga  
Në themelet.  
Dhe makjet lulëzojnë mes klimës mesdhetare,  
Mbi kodra jugu fryn, ndaj dallgët po gëzohen.  
Unë ndjej në kaltërsi si klith  
Vjeshta detare  
Mbi zallet që me shkumë dhe leshterik  
Mbulohen.

~~50974~~

BIJOTEKA E SHITENJES  
SHITENJES

14571

Po iki i ngarkuar me dashurinë dhe mallin  
Që më jep gjithmonë kjo kripë e bardhë.  
Po mbart këtë pejsazh që fëshfërin nga muzgjet,  
Në dej më rrjedh deti i mirë Adriatik.  
Dhe ti o këngë vërtitu si një zhgalem mbi shkulmet  
Mbi qiellin e Currilave në ajër  
Përjetësisht.

## VARRET PARTIZANE

Për çdo ditë bashkë me bardhësinë e agimeve,  
Atdheu derdh mbi ta dashurinë e përjetshme  
E buzëqeshja e tij, aq e çiltër, e lirë  
Porsi kurorë lulesh  
Pranë u rri.

Të rënët flenë.  
Të rënët flenë të pavdekshëm në përjetësi.  
Atdheu, shokët, janë pranë si dikur  
Gjatë betejave, sulmeve, luftimeve.

Të rënët flenë.  
Në gjoks të tij i ka marrë Atdheu.  
Janë fëmijët, gjaku i tij  
Nga zemra e tij u jep jetë,  
Ata rrojnë.

Varret partizane.

Çdo ditë, bashkë me bardhësinë e agimeve  
Atdheu derdh mbi ta dashurinë e përjetshme,  
Mbështetet i sigurtë  
Tek sulet ndër beteja.

Varret Partizane

Themele të kuqe të kohëve të reja.

## TRAKTORISTI

Erdhi pranvera;  
Lëkurën e dimrit,  
Peliçen tërë vajra  
Traktoristi e vari te dega e bajames  
Te degëza e njomë e veshur me lule të bardha.

Erdhi pranvera;  
Tërë ditën pistonat të nxehur  
Tërë natën dritat të ndezura.  
Këtë pranverë,  
Traktori i tij njëzet vjet i vjetër  
Punon për llogari të njëzet vjetëve të ardhshëm,  
Punon në afërsi të mijëvjeçarit tjetër.

Erdhi pranvera,  
Koha shtrihet si fushë pa kufi.  
Pranverat plugohen si parcela  
Dhe tani pelicja e tij  
Flamur i një heroizmi të heshtur  
Valavitet pranë vitit dymijë.



## REZERVUARI

Si një copëz qielli kaltëron ai atje,  
Atje mes kodrave me dushqe

Në ujë pasqyrohen peisazhet përreth  
Dhe ky ujë i kthjellët i maleve  
Do derdhi gjelbërimet poshtë fushave.



## U NISËN KARROT

U nisën karrot njëra pas tjetrës varg  
Po shkon në depo ky gruri i ri  
Dëgjoje këngën, ndihet që tej, larg  
Bukë e këngë bashk' gjithnji.

U nisën karrot njëra pas tjetrës varg  
Grurin e ri po dorëzojmë ne,  
Dëgjoje këngën, ndihet që tej, larg  
Djersën, bukën e parë për ty, Atdhe.

## KOPEJA

Si një re e bardhë e shkrifët që ikën duke  
u zvogëluar  
Ngjan kopeja në mëngjez kur ngjitet malit për  
në kullotë,  
Dhe ndaj të perënduar,  
Kur kthehet,  
Si një ortek i vogël dëbore që rrokulliset poshtë  
Duke u zmadhuar.

## LAPIDAR NË MES TË GJELBËRIMIT

A kini parë rrugës kur kaloni  
Me zemrën mbushur me afsh të gëzimit  
Se, si medalje në gjoksin e fushës,  
Një lapidar ngrihet mes gjelbërimit?  
Dhe në e kini parë fluturimthi  
Mundimin merrni,  
Ndaluni një herë:  
Është lapidar i një komunisti  
Që ra një ditë dielli në pranverë.  
Është lapidar i një trëndafili  
Që në çdo zemër shpërndan aromë,  
Nëpër këtë fushë që sa zë vështrimi  
Ai treste syt e tij të njomë.

Dhe, në mos paçi në duar buqetë,  
Ju lapidarin puthjani në ballë.

Atë e vranë kafshët me helmetë  
Që nëpër botë mbollën veç llahtar.

Ai ëndërronte që të ish Atdheu,  
Një ditë të afërt,  
Krejt i gjelbëruar,  
Dhe kur po fikej, ai e pa, e ndjeu,  
Se dit' e madhe  
Ishte në t'aguar.

A kini parë rrugës kur kaloni  
Në mes gjelbërimit, lapidar?  
Po s'patët lule, në shenjë dashurie  
Ju lapidarin puthjani në ballë!

## NJERIU I VOGËL

Mes nesh rron i strukur  
Njeriu i vogël,  
Që botën e madhe e mat në vetëveten  
Dhe qiejt e pafund me kupolën e dhomës  
ku i plogët,  
i vetëm  
mes pluhurit ecën.  
Tek ai s'gjen jehonë asnjë tingull i jetës.  
(A mund të ngresh dallgë dhe stuhi  
në një pellg?)  
Ai është i lindur  
Të zvarritet mes këmbësh  
Si kaktus në shkretëtirën e së vjetrës  
Që vdes.  
Hedh rrjetat, peshkon  
Si merimangë nëpër qoshet  
ku rrinë gjithë ata që kanë frikë nga gjëmimet,

Mes legjendash biblike mbështjellë me  
lëvozhgën

E egoizmit, mërziisë  
Mbi ritet dhe mitet.  
Zë vend në ndërgjegjen e njerëzve të cekët  
Dhe i bën ata me këllëf  
Të dyfishtë

Dhe është përfaqësuesi më dinak dhe i egër  
I armikut të klasës, fshehur thellë  
Si një thikë.

Fryjnë erërat nga gjokset që këndojnë në  
kantieret

Dhe krahët i tundin flamujt rreth e qark  
Dhe njeriut të vogël befas  
Fryma i merret

Kur sheh

Gjithë kanunet dhe zakonet në flakë,  
Se po humb aleatët e tij të devotshëm,  
Priftërinjtë dhe mblesët që u zhdukën si korbata

Dhe prapset i verbuar

Nga shkëlqimi i kohës

Si terri i natës

Bashkë me ujëqit në strofkë.

Klasë punëtore, ç'o grushtin sa Korabi mbi  
kokën

E mikroborgjezit,

Burokratit,  
Servilit  
Që prej vetes të shkullim  
Ne njeriun e vogël  
Nga retë t'i filtrojmë horizontet e shpirtit.  
S'ka mbaruar beteja — ky duel i dy botëve,  
Ndaj me klasën time,  
Si shqiponjë në shtrëngatë  
Do sulem, ku fton plot dritë  
Dhe fitore  
Fjalimi i 6 shkurtit si flamur në katart.

## PALOMBARI I VJETËR

Mbi rrezet e detit në bord të anijes  
Unë shikoj palombarin e vjetër, xha Ropin,  
Si vesh në qetësi skafandrin e zhytjes  
Dhe futet  
Ngadalë nëpër ujërat e portit.  
I rëndë zbret në fund  
Mes zhurmës së ajrit  
Që i mbulon skafandrin me lulëzime flluskash  
Për t'i ndrequr anijes skafin e bashit  
Të dëmtuar në udhëtime,  
Në tallaze fortunash.  
Që atje dielli duket i vogël si perlë  
Nën guackën kristal të përkulur të qiellit,  
Atje drita i thyhet  
Në vezullime përreth  
Që nga luspët e peshqëve  
Dhe yjet e detit.



Dhe punon në skajin e hekurt, të ndryshkur,  
Që ka zënë

Mozaik të çuditshëm koralesh  
Edhe fluckat si zinxhir ajror dhe i ndritur

Në sipërfaqe treten

Nën flade valësh.

O xha Ropi, xha Ropi

Kështu jeta t'u tret

Në punë dhe në zhytjet e përhershme në ujë.

Se ç'zanat i ndershëm,

I mirë dhe i rëndë,

Që të bëri t'i duash thellësiat kaq shumë.

Ndaj nga borti i anijes,

Me respekt unë shikoj,

Si xha Ropi del sipër dhe skafandrin e heq

Edhe ndez një cigare

Ndërsa porti zhurmon,

Ndërsa era flokët e thinjur

Ja prek.

## ATDHEU

Ka vend më të bukur se Atdheu yt?  
Ka vend ku malli kaq shumë rëndon..?  
Kur jemi larg atje i hedhim sytë,  
I rëndi gur në vend të tij peshon.

## BATICË

Ashtu si ngre hëna oqeanin në baticë  
Ashtu liria ngriti popullin një agim  
Në agimin e festës së lashtë hënore  
Rrugët u mbushën me lule e me plumba  
U mbushën me vërshëllimën e urrejtjes  
popullore.

E tmerrshme ju turr batica e hakmarrjes  
Ambasadës së urryer,  
Gjer në katet e larta  
Dhe nga mushkërit e saja të korracuara me  
beton-arme

Si flluska fluturuan jankitë me bizhame  
Ashtu si ngre hëna oqeanin në baticë  
Ashtu liria ngriti popullin një agim,  
Në agimin e festës së lashtë hënore  
Që nga rrafshnalta e Dalatës  
Gjer në Huen legjendare  
U valvitën flamurët e kuq të fitores.

## REVOLUCIONI YNË

Nga lindja deri në perëndim,  
Nga veriu deri në jugë  
Të atdheut tim  
Revolucioni ynë çan rrugë  
Me flamurin e kuq në dorë  
Drejt fushash,  
Kodrash  
e malesh.  
Ai, krejt truallin arbëror  
E ndrit me miliona  
vezullime kristalesh,  
mendjesh e vullnetesh njerëzorë.

## SHOKËVE TË MIJ

Nga brigjet e huaja ku kaloj  
O shokë, ju përshëndes që larg!  
Në të vërtetë lundroj, lundroj,  
Por pranë jush jam or' e çast.

Larg Atdheut zemra të digjet  
Jo vetëm për shokët e familjen  
Po dhe për gurët, kodrat dhe brigjet,  
Asgjë nuk barazohet me vendlindjen...

## KËNGA E AKSIONEVE

Aksione të mëdha na thërrasin,  
Ndaj djersa çurk na pikon,  
Ndaj djersa e lumtur bie  
Dhe si degë peme lëshon  
Gaz, vrull, entuziazëm rinie.

Aksione të mëdha na thërrasin,  
Ndaj jemi të atdheut ushtarë,  
Ndaj udhën e komunizmit ne hapim,  
Me zjarrin revolucionar.



## DRITAT

Po ngjiten lart e më lart,  
ndër kodra e male,  
drejt qiellit  
shtyllat e bardha kapur me tela  
si në valle  
për të marrë prej diellit të Partisë  
dritat e arta,  
e për të qendisë mbi të shtrenjtën tokë  
qindra dhe mijëra yje të kulluar,  
që Shqipëria optimiste  
të ndrisë si agim i praruar,  
agim i ngjyrave komuniste.



## VARGJE PËR TY, RROGOZHINA IME

Të shoh, qyteti im i vogël  
Si të zgjojnë mëngjezeve  
Boritë.  
Vargan maqinash  
Të pafund;  
Dyndet zhavori  
Drejt trasesë.  
Mbi sponde maqinash  
Valaviten flamujt e brigadave.  
Skelete urash,  
Ura të aksionit  
Që kanë të shkruara në këmbët e tyre  
Parulla të revolucionit.  
Brezat e ardhshëm do të pyesin  
Si u sajua këtu,  
Në mes të kësaj fushe,  
Ky mal zhavori.

Sirenat do të buçasin  
Do të grisin heshtjen e natës,  
Në aksione të reja  
Do të na thërrasë  
Zëri i Shkurte Vatës.

## NË PLAZH

A e di ti, e dashur, legjendën e moçme  
Për sirenën e bukur që rron thellë në det,  
Në një shpellë prej guackash  
Dhe myshqesh ujore,  
Ku ajo rri mbi perla  
Gjysëm vajzë  
Gjysëm peshk?  
Atje rron bashkë me peshqit,  
Me moluskët, sfungjeret  
Dhe del veç një herë  
Në një qind vite sipër  
Dhe shpëton peshkatarët  
Që i përplas tramundana  
Përmes brymës dhe stuhive të acarta  
Në dimër.  
Pastaj qesh edhe ngroh  
(Porsi dielli) ujërat

Dhe kreh flokët e saja të verdhë hënore.  
... Dhe me ne kështu ndodhi.  
Ti notove tek unë  
Duke dalë që nga deti  
Si në legjendën e moçme.

Përmbi plazh ndriste rëra  
Dhe shkuma trishtonte  
Unë të putha fytyrën e qeshur në muzg  
Se mos valët  
Ngadalë  
Të rrëmbenin prap  
Në gjirin pa fund.  
Por valët e vakta na spërkatën në ajër,  
Me dashuri të përjetshme mbi plazhin  
e kaltër.

## KËSHTU E FILLUAM NE...

Kështu e filluam ne  
Në mes të uturimës së lumit që rrjedh  
me furi,  
Në mes shkëmbinjve që ngrihen gjer në re...  
E filluam me vrull rinor,  
Me gjoks të hapur përpara stuhisë  
Flamurin e kuq rrëmbyem në dorë...!

## KALTËRSI

Mesnatë. Kampi merr fymë dhe fle.  
Ëndrrat e shokëve u nisën shtegtimeve  
Mendimet e mia dot në gjumë s'i ve.  
Ato roje këtë natë u bëjnë ëndërrimeve...

Hesht kampi i fjetur, fle gjithësia.  
Veç deti s'ka gjumë, thur këngë lirike.  
Si deti zhurmojnë mendimet e mia  
Eh, qenkam një copë kaltërsi adriatike.

## NDËRTESE PËR KËNGËT E LAGJES

Një ndërtesë e bukur  
u ngrit në mes të lagjes.  
E bukur dhe e madhe!  
U ngrit ajo  
    prej zemrave  
    dhe muskujve të lagjes.  
Me dritare  
    që shohin nga lindja,  
E para ndërtesë jona  
    me punë komuniste  
Dhe të parat që hynë në të,  
në të shkrepur të diellit,  
qenë këngët.  
Këngët e lagjes sonë...!  
U mblodhën dhe jehuan aty  
    të gjitha këngët e lagjes.  
Dhe tani,

ne kemi për këngët tona  
një pallat.  
Dhe tani,  
ndërgjegjja e lagjes sonë,  
u ngrit më lart  
edhe një kat.



## DËGJO O CEM...!

Dëgjo, o Cem,  
Ç'dëshirë më vlon në gji  
Më fal në qoftë se them të vërtetën,  
Këtë frymëzim nuk ma dhe ti.  
Jo!  
Ky ujë që rrjedh i kristaltë.  
E gurgullon mes gurësh me furi,  
Nuk më dehu me fantazi  
E romantizëm këtë radhë.

Dëgjo, o Cem krenar,  
Si mbytet oshëtima jote  
Nga zhurma e kazmave që çajnë  
Shkëmbinjtë e fortë shekullorë...!

## DIKUR

Do rrjedhin vitet, shokë të aksioneve,  
Ju, që pleqërinë s'e njohët kurrë,  
kur,

siç ju nisnin prindërit perroneve,  
fëmijët tuaj do nisni dikur.  
Do ketë mbetur pa u lidhë akoma  
Me hekurudhë ndonjë fshat malor  
Dhe ju do nisni dashuritë e njoma  
Drejt tij, si vërshim ujërash pranveror.

Dhe ai do jetë pika më e gjallë  
Dhe m'e populluar e planeteve,  
Drejt tij do ngasin turistët me radhë  
Me të do mbushen faqet e gazetave.

Veç ju, mbështjellë me zhurmat e perroneve,  
Do mbesni në horizont, vegim i mpiksur,  
Duke tundur shallet e aksioneve  
Të viteve të largët e të ndritur.

## DY TELA

Dy tela,  
Si dy damarë që çojnë gjak,  
Do të çojnë dritë  
Atje,  
Ku nxijnë hijet e djeshme.  
Në të kuq do të ndizen llambat  
Do të ndrisin ngjyra të qeshura,  
Terri i natës do të digjet nga shkëlqimi,  
Bishtukut i erdhi perëndimi.  
Do të derdhet drita si ujë burimi  
Me flak' dielli  
E bojë agimi!

## DHURATË PARTISË

Është mbrëmja e fundit  
E kohës së aksionit,  
Ushtojnë këngët, marshon rinia  
Në ballë flamujt e revolucionit.  
Tingujt e këngës mbi të renë trase,  
Njëra pas tjetrës  
Të zgjojnë, Myzeqe.  
Shkurte, Shkurte a dëgjon,  
Si shend këngë e rinisë?  
Hekurudhën e ndërtuar  
Ja dhurojmë nënës sonë,  
Partisë!  
Dhe gazi i rinisë  
Hedh valle  
Në gjoks të aksionit,  
Përzihen me të  
Tingujt e sirenës  
Së lokomotivës, së revolucionit!

## DËGJONI ARMIQ!

Ju, që me zërin e çakenjve ulurini,  
Ju, që mprehni thikat atdheut tim gjoksin  
për t'ja çarë

Dëgjoni!  
Po ju flas unë,  
Vajza e rilindur shqiptare:  
Mbi kokë kam mbajtur në shekuj  
Aq vuajtje,  
Aq uri,  
Aq kanune,  
Aq padrejtësi,  
Sa cilido tjetër do të kish vdekur.  
Por unë rrojta,  
Rrojta që t'i flisja historisë,  
Rrojta  
Të shihja agimin e lirisë.  
Dhe tani atë s'ma rrëmben dot askush.

Provoni po deshët  
Atdheun t'ma sulmoni,  
At'here do të shihni  
Si do të qëlloj me pushkë  
Kundër jush.

## KATËR LULEVE TË BARDHA

*(Parashutisteve të para)*

Atë mëngjez  
Kur ende vesa shkëlqente  
Mbi gjelbërimin e ri,  
Me sy dhe zemër ju përcollëm  
Drejt qiellit pa kufi...  
Dhe zbritët krenarisht  
Mbi tokën mëmë  
Si katër lule të bardha,  
Që lajmërojnë  
Një pranverë të madhe.  
Zbritët ju,  
Dhe mbetët përjetësisht  
Në epopenë e gruas Shqiptare...



## BALLADË

Tufën e la nën hijen e bredhit të motshëm si  
jetime  
Dhe vetë u nis thellë pyjeve të gjejë çetën  
partizane.  
Në mbrëmje tufa u kthye në fshat vetëm, pa bari  
Ndërsa bariu i fshatit as mbrëmjen tjetër s'u  
kthye në shtëpi.

## NËNËS PUNËTORE

Mesnata afroi,  
Të gjitha dritat janë shuar në qytet,  
Dhe nëna  
fëmijën në gjumë përqafoi  
vogëlushin e saj

plot shëndet:

Hëna nazemadhe,  
nuk duket gjëkund.

Bie shi.  
Era që fryn,  
gjethet i shkundi

dhe ecën nëna  
punëtorja e re.

Sirena e fabrikës

të thërret ty, nënë.

Sirena e saj, alarm për ty,  
ndaj ti tani shpejtoje çapin e rëndë.  
Në turnin e natës  
gjumi si plumb rëndon mbi qepallat  
mbi qepallat e dashura, nënë,

Por ri,  
i komandon dhe qepallat  
ashtu si komandon me lehtësi maqineritë.  
Në mendje,  
në zemër,  
në vesh të buçet:  
Atdheu do punë,  
do punë atdheu,  
se puna juaj për armikun do jetë:  
Humbje,  
vdekje,  
varr.

Këtë këngë ta thur yt bir, moj nënë.  
Natën, në një dhomë plot dritë,  
Nënë, unë do të bëhem poet  
Le të t'i shtojë kjo kënga ime fuqitë.

## NE DO ECIM TË DY GJITHMONË....

Ti shkove bjeshkëve me libra në dorë  
Larg, larg,  
Qindra kilometra  
Atje ku dielli do jetë më i artë  
Kur t'u priten kanuneve rrënjët e vjetra.

Ne do ecim të dy gjithmonë pa u ndarë  
Në dhjetëra, qindra beteja  
Duke ndjekur revolucionin në vijën e parë,  
Malësive duke mbjellë dashuritë e reja.

## TË RËNËT

(YJET)

Janë plagë,  
Që do të dhembin përjetë,  
Janë dekorata,  
Që do të skuqin përjetë,  
Janë pranvera,  
Që do të blerojnë përjetë.

## SHQIPES SË ARBËRIT

Kur ike ti, sulltanët pa mend mbenë:  
«Ç'deshe vallë, arnauti Skënderbe,  
Mos nuk të sosi fama që muar dhenë,  
Apo haremesh s'pate Shahname?»

E nga ta dinin dot anadollakët  
Se ç'kishe parë e ndjerë në Shqipëri,  
N'ata vite të mugët e të largët  
Të së pafates tënde fëmini?

E nga ta dinin dot anadollakët,  
Se shqipja s'mund të ngrejë dot fole  
N'ajrin e fëlliqur e të vakët,  
Larg majash kryekredhura në re?

E nga ta dinin dot anadollakët,  
Se s'mund të ketë heronj pa mëmëdhe!

## PARA MONUMENTIT

S'u derdhe nga dor' e skulptorit  
Në bronx e në hekur majë kalit,  
U derdhe nga zemra e kombit  
Nga këngët si ujët e malit;  
Dashuria e tij të dha formën  
Në urrejtjen e tij u kalite,  
Mbi male, si mbi supe, vure dorën  
Dhe kalit mes sheshit iu ngjite.

## KUFITARIT

Madhështor qëndron në piramidë,  
Trojet tona ti mbron me guxim,  
Pulsi i atdheut që rreh furishëm,  
Të fal kufitar, forcë, frymëzim.

Atje nuk trembesh netëve të errta,  
Kur me vdekjen përzjen dashurinë,  
Dëgjon buçimën e rrjedhës së jetës,  
Pishtar i idealit rrugën të ndrin.

Atje në agimet e reja boreale,  
Ku rrjedh Valbona dhe pylli dremit,  
Minat përcjellin shkëmbinjtë ndër hone,  
Ti, kufitar eopenë skalit.



## ALARMET

(Fragment)

Atdheu nuk fle!  
Alarm, alarm, alarm!  
Pra, shqiptarët nuk flenë!  
Alarm do të thotë  
Edhe një herë në sup armët!  
Të gjithë kanë veshur rrobën e gjelbërt,  
Rrobën e ushtarit,  
Dhe gjithkush, armën e tij shpejt e rrëmben  
Dhe nën këtë robe të gjelbërt  
Dhe me këtë armë të thjeshtë,  
si vetë shqiptari  
U ngritëm të mbrojmë gjelbërimin  
e përjetshëm të Atdheut!

## BRIRËT E DHISË SË EGËR

Mbi masivin shkëmbor të Atdheut  
Si dy shkrepëtima që çajnë mes tufanit  
Sipër shkrepave  
Sipër kurorave malore  
U ngritën brirët e dhisë së egër të shkëmbit  
Andej i mori populli dhe i ngriti mbi legjenda,  
I ngriti mbi lahuta,  
Mbi këngë kreshnike;  
Pastaj Skënderbeu i ngriti dhe më lart  
Mbi krahët e lirisë,  
Mbi lavdinë e kombit  
Si dy shkrepëtima që çajnë mes tufaneve  
armike.

## NJË MBRËMJE

Një mbrëmje kaluan zboristët mes qytetit,  
Një mbrëmje të vrërët,  
Të vonë.  
Kaluan me këngë;  
Në rrjeshta të gjatë,  
Nën borën që binte  
Nën dritat neon.

U hapën dritaret në katet e sipërme  
Dhe si agime boreale kryqëzuan dritat  
Mbi vezullimin e mitralozave,  
Mbi lëkundjet e antenave,  
Mbi kapotat e lagura dhe helmetat e çelnikta.  
Kaluan ata me këngë partizane  
Dhe në drejtim të maleve humbën në muzg.  
Qyteti i përcolli me dritare të hapura  
Si kaçube që shkundin petale mbi rrugë.

## DĚSHMORĚT

DĚshmorĚt  
heronjt e tokĚs mĚmĚ.  
Nga gjaku i tyre qĚ dikur  
skuqi dhenĚ,  
filizat e rinj lindĚn me mijĚra  
Dhe filizat lĚshuan rrĚnjĚ e degĚ  
e u pĚrhapĚn me shumicĚ  
nĚ gjithĚ  
ShqipĚrinĚ.

## NË FUSHIM

Natyrë,  
Gjelbërimit tënd ju shtuam edhe ne,  
Me muskujt e hekurt,  
Me rroben tonë të blertë  
Erdhëm tek ti me armë, në fushim,  
Për tokën tonë të derdhim djersë.  
Dhe të godasim si rrufe,  
Me predhën e parë,  
Në shenjën e zezë!

## AI RA...

Ai ra...  
Malet ulën kokat,  
Oshëtimat buçitën.  
Një shpirt i blertë u tha,  
Një pushkë heshti,  
Mijëra u ngritën.

Ai ra,  
Dhe sytë ëmbël mbylli mbi tokën e urtë,  
Shokët e mbuluan me flamurin e betejave,  
Sikur ta kishin mbuluar,  
Me një copë horizonti muzgu  
Të ndezur,  
Të purpurt.

## MOS U MËRZIT, O XHELO...

Shokët e mij  
Që të gjithë flenë  
Dhe ndoshta mes ëndrrash  
Ndodhen tani...  
Po Xhelua?  
Ç'të ketë sonte vallë,  
Që gjumi s'po e zë...?  
Vetëm unë,  
Roja i kapanonit  
I afrohem  
Dhe miqësisht bisedoj me të...  
Xhelua rri shtrirë  
Dhe sytë ngulur qiellit i mban,  
Sikur gjithë yjet kërkon t'i numërojë,  
Apo ndoshta shqetësimin  
Mes tyre kërkon të ngatërrojë...  
Por jo,

Brenga Xhelos  
I duket e rëndë sa një mal.  
Pushkatarit i vjen të pëlçasë  
Që s'mundi dot,  
Me tre plumba  
Një «armik» të vrasë...



## DO TAKOHEMI PËRSËRI

Ushtarë të liruar  
Që përkuleni te spondei  
Me shokët përqaftuar  
Lamtumirë!  
Kamionet do nisen  
drejt rrugëve të gjata.  
Drejt qyteteve dhe fshatrave të largëta  
Ushtarë, lamtumirë!  
Ne, rekrutët, morëm armët tuaja  
Dhe veshëm uniformën tuaj  
Si në një stafetë,  
Si në një turn u ndërruam.  
Tani  
lamtumirë!  
Po! Do takohemi përsëri  
Do takohemi te tarracat e maleve,  
Te digat e hidrocentraleve.

Do takohemi përsëri  
Në jugë dhe në veri,  
Se nuk ka për ne rrugë të gjata  
As fshatra e qytete të largëta.  
Po të marrësh frymë në veri  
Ndjen aromën e ullinjve të jugut,  
Po të marrësh frymë në jugë  
Ndjen aromën e pishave të veriut.  
Kaq e afërt  
Kaq e dashur është toka e Atdheut!  
Ushtarë,

lantumirë!

Do të takohemi përsëri  
Do të takohemi përgjithmonë  
Në jugë e në veri.

## QYTETI I IM I THJESHTË, I DASHUR

(Poemë)

Që kur frymëzimi m'u shfaq i ngrohtë në zemër  
Unë vazhdimisht pëshpërisja një varg:  
«Qyteti im, i thjeshtë, i dashur».  
Ky varg u poq me dashurinë time  
Ashtu siç piqen frutat në pemë.

\* \* \*

Qyteti im i thjeshtë, i dashur,  
Me gjoksin tënd akoma thithje  
Atë ajër të prishur  
Të botës së kalbur.

Në majë të minaresë së xhamisë mesjetare  
Kur ne, të falnim Ramazanin shkonim,

Dilte hoxha  
Pëlliste dhe çirrej,  
Dhe ne besonim se fliste me zotin.

Mbylleshin qepenat,  
Treteshin njerëzit,  
Drejt sofrave të shtruara vraponin t'uritur.  
Tërë ditën barku u ngjitej pas shpine  
Që të shkonin pas vdekjes  
Në «botën e ndritur».  
Kështu je përkundur në djepin e shekujve,  
Me sytë të mbyllur nga gjumi i injorancës,  
Ti s'dije ç'ish drita,  
Bota,  
Përparimi,  
Ti veç kalbeshe në pellgun e baltës.  
Po u desh që të ngriheshim ne,  
Të të nxirrnim në brigjet e ndritura,  
Dritaret e pranverës së madhe  
T'i hapnim me pushkë,  
Me jetë,  
Mbi llohen,  
Lotët;  
Errësirën,  
Me gjakun e pranverave tona;  
Të shtronim të kuqen  
Të ardhmen tënde.

\* \* \*

U futëm nëpër rrugët e tua  
Nën diellin e lirisë,  
Dulke mbajtur pranë  
Pushkët akoma të ngrohta  
Nën qiellin e ri,  
Të pastër  
Plot yje.

Kishin rënë qindra,  
Po ishin ngritur mijëra,  
Për të vazhduar këngën e atyre që ranë.  
Kishte rënë Mehmeti  
Që sapo kishte nisur  
Belbëzimet e para të vjershave,  
Me buzët e ngjitura pas grykës së pushkës,  
Me një këngë partizane nëpër buzë,  
Me një këngë të së ardhmes  
Që s'arriti ta mbaronte.  
Ai u shua,  
Po ne vazhduam këngën e tij  
Ai vetëm kështu mund të vdiste i qetë!

Po, mijëra kishin rënë,  
Kishte rënë Leonidha,  
Leonidha, që i deshte aqë shumë yjet,

Leonidha që desh t'u ngjante yjeve,  
Kishin rënë  
Raziu,  
Millani,  
Vangjeli,  
Fiqiriu,  
Në brigjet e pranverës  
Duke skuqur me gjak  
Flamurët e bërë shoshë  
Nga plumbat e armiqëve,  
Duke u dhënë shkëlqim  
Gjithë trandafilave të jetës.  
Ndryshe asnjë lule  
S'do të kishte çelur,  
Ndryshe  
Do dergjeshim akoma  
Nën qiellin e djegur.

\* \* \*

Tek eci netëve nëpër trotuare  
Nën dritat e neonëve që reflektojnë asfalteve,  
Hijet, që herë zgjaten dhe herë mblidhen  
Më bredh mendimi  
Në shtigjet e kujtimeve  
Ku më dalin përpara rrugët e ngushta,  
I vjetri qytet që gjurmë më s'i mbeti.  
Ku vanë tymrat e botës së vjetër?  
Pse hoxha me zotin më nuk flet?

Një ditë buldozeri në botën tjetër  
E çoi xhaminë,  
Blozën e shekujve.  
Ai s'ish buldozer,  
Po revolucioni,  
Që botën e fishkur,  
Hodhi në kraterë.  
Ai ish revolucioni,  
Zjarr i Partisë  
Që në flakën e kuqe dogji pa mëshirë,  
Perçet e zeza,  
Kishat,  
Xhamitë,  
Që ty, moj Kavajë e Moisiut.  
Të të ndizej në buzë,  
Gazi i dliirë.

\* \* \*

Qyteti im i thjeshtë, i dashur,  
Mbrëmjeve kur yjet të të ndizen përmbi krye,  
Siç ndizet në zemrën tënde dashuria,  
Shoh punëtorët tek kthehen nga puna  
Me fytyrat e djersitura  
e të lumtura  
Dhe s'më mbetet gjë tjetër  
Veç në udhë ta nis frymëzimin  
Ku si lumë brilantesh  
derdhet heroizmi.

## M A M I A

Në fshatin e struktur rrëzë sukash dushkore  
Një dorë që vonë troket t'i pret ëndrrat në mes,  
Ti zgjohesh përgjumësh,  
Xhami dridhet në dritare .  
Pas xhamit,  
Pas frymëmarrjes së avullit  
Kërruset një siluhetë.

Një baba ka ardhur te dritarja e ambulancës  
Në terrin e natës;  
Gruaja e tij dergjet në kullë  
Dhe të pret .  
Fëmija e tij, që akoma s'ka lindur  
Të thërret.

Nga nxitimi,  
Ti i vesh pa çorape çizmet e ftohta .



Nga nxitimi, e harron edhe shallin  
Dhe sulesh te porta.

Qielli hedh florinj yjesh  
Sukat hedhin fletë dushqesh,  
Fletë të vona,  
Yje të vonë;  
Rruga për te kulla  
Në të përpjetën e malit dredhon.

Pas siluhetës së malësorit  
Si djalosh ti i ngjitesh malit.  
U hukat gjishttrinjve  
Sa e ftohtë kjo natë e fundit e dhjetorit!

Dëgjon erën që grindet me dushqet  
Thellë shtigjeve të pyllit,  
Sheh qiellin dhe të duket se dhe yjet  
Dridhen e përpëliten prej thëllimit.

\* \* \*

Dhe ja, kulla nën dritën e hënës  
Ja, nëna e re nën dritën e llambës

Ti qëndron atje,  
Pranë saj,  
Duke pritur,  
Në portat e jetës,  
Roje e pafjetur qëndron  
Gjersa shuhet hëna dhe llamba  
Gjersa dëgjon në agim të qarat e para.  
Sa net të tilla i ke gdhirë gjer në agim!  
Sa agime të tilla i ke pritur në zgjim!  
Të janë mbushur këto net me rënkime lehonash,  
Të janë mbushur këto agime me të qara  
foshnjesh.  
Të është mbushur jeta jote  
me jetët e tyre të njoma!

\* \* \*

Tani të shoh tek kthehesh përsëri nga mali  
Kalon pranë tërmetit të mposhtur,  
Të nënshkruar  
Dhe shikon shtëpitë e reja në agimin e praruar.  
Kalon pranë tufave të deleve jugore  
Që kanë ardhur e kanë lindur qingja në veri  
Kalon pranë kabinës elektrike që është ngritur  
Buzë ujit ku vezullonin zanat në lashtësi.

\* \* \*

Kalon dhe zbret.  
Te ambulanca një siluhetë tjetër të pret.  
Një baba tjetër,  
Një nënë tjetër,  
Të pret një rrugë dhe një foshnjë tjetër.  
Kështu do të presin gjithnjë këto silueta,  
Kështu do të shkosh te këto rrugë,  
Kështu do të shfaqen si vegime të përjetshme  
Këto foshnja  
Në mesnatë dimri  
Në muzgje të zbehta  
Në agime mavi të trëndafilta e të blerta.

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Toka shqiptare .....	<i>Pavli Dhroso</i>	5
Këngët .....	<i>(Et'hem Hysi)</i>	6
Në atë shtëpi .....	<i>(Stefan Kume)</i>	7
Udhët .....	<i>(Stefan Kume)</i>	9
Në kantier .....	<i>(Moikom Zeqo)</i>	11
Babait tim shofer .....	<i>(Ramazan Hushi)</i>	13
Ekavatoristi .....	<i>(Edip Hoxha)</i>	15
Vargje për Currilat .....	<i>(Moikom Zeqo)</i>	17
Varrët partizane .....	<i>(Josif Doja)</i>	19
Traktoristi .....	<i>(Edip Hoxha)</i>	21
Nisja .....	<i>(Lolo Kume)</i>	23
Rezervuari .....	<i>(Ali Bada)</i>	24
Nisën karrot .....	<i>(Stefan Kume)</i>	25
Kopeja .....	<i>(Ali Bada)</i>	26
Lapidari në mes të gjelbërimit .....	<i>(Josif Doja)</i>	27
Njeriu i vogël .....	<i>(Moikom Zeqo)</i>	29
Palombari i vjetër .....	<i>(Moikom Zeqo)</i>	32
Atdheu .....	<i>(Ramazan Hushi)</i>	34
Baticë .....	<i>(Edip Hoxha)</i>	35
Revolucioni ynë .....	<i>(Vlash Tati)</i>	36
Shokve të mij .....	<i>(Lolo Kume)</i>	37
Kënga e aksioneve .....	<i>(Bardhyl Agasi)</i>	38
Këngë .....	<i>(Edip Hoxha)</i>	39
Oritat .....	<i>(Vlash Tati)</i>	40
Vargje për ty, Rrogzhina ime .....	<i>(Et'hem Hysi)</i>	41
ë plazh .....	<i>(Moikom Zeqo)</i>	43

	Faqe
Kështu e filluam ne .....	(Sami Rubi) 45
Kaltërsi .....	(Javer Beqiraj) 46
Ndërtesë për këngët e lagjes .....	(Et'hem Hysi) 47
Dëgjo o Cem! .....	(Luljeta Muço) 49
Dikur .....	(Met Gjergji) 50
Dy tela .....	(Ligor Gjiria) 52
Dhuratë Partisë .....	(Mehdi Disha) 53
Dëgjoni armiq! .....	(Merita Ndreko) 54
Katër luleve të bardha .....	(Petraq Qafëzezi) 56
Balladë .....	(Ali Bada) 57
Nënës punëtore .....	(Aqif Dino) 58
Ne do ecim të dy gjithmonë .....	(Ramazan Hushi) 60
Të rënë .....	(Josif Doja) 61
Shqipes së Arbrit .....	(Met Gjergji) 62
Para monumentit .....	(Met Gjergji) 63
Kufitarit .....	(Vera Llaka) 64
Alarmet .....	(Thanas Mustaqja) 65
Brirët e dhisë së egër .....	(Edip Hoxha) 66
Një mbrëmje .....	(Edip Hoxha) 67
Dëshmorët .....	(Asllan Haxhija) 68
Në fushim .....	(Malo Faci) 69
Ai ra .....	(Josif Doja) 70
Mos u mërzit, o Xhelo .....	(Petraq Qafëzezi) 71
Do takohemi përsëri .....	(Edip Hoxha) 73
Qyteti im i thjeshtë i dashur .....	(Josif Doja) 75
Mamia .....	(Edip Hoxha) 80